
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDACIONI “LOGOS”
KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”**

SENATI AKADEMIK



RREGULLORE PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Tiranë, 2019

RREGULLORE PËR SIGURIMIN E CILËSISË

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

1. Kjo Rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave, procedurave dhe mekanizmave për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” (KU “LOGOS”).
2. Kjo Rregullore përcakton rolin dhe përgjegjësitë e organeve dhe autoriteteve drejtuese, të strukturave akademike dhe administrative, të organizmave të posaçme të KU “LOGOS” për sigurimin e cilësisë.

**Neni 2
Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj Rregulloreje janë: Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Statuti i KU “LOGOS” (2017) dhe Rregullorja e KU “LOGOS” (2017).

**Neni 3
Fusha e veprimit**

1. Rregullorja ka si fushë veprimi sigurimin e cilësisë që i referohet një procesi të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi, dhe përmirësimi të cilësisë së institucionit të KU “LOGOS” dhe programeve që ai ofron duke u bazuar në kriteret të brendshme dhe të jashtme. Menaxhimi i cilësisë, rritja e cilësisë, kontrolli i cilësisë, dhe vlerësimi i cilësisë janë mjete nëpërmjet të cilave sigurohet cilësia.
2. Kjo Rregullore i shtrin efektet mbi të gjitha aspektet e veprimtarisë së KU “LOGOS” që janë objekt i sigurimit të cilësisë së parashikuar sipas kësaj Rregulloreje, mbi të gjithë aktorët që përmbushin misionin e KU “LOGOS”; mbi të gjithë ata që kanë përgjegjësi për sigurimin e cilësisë: organet dhe autoritetet drejtuese, strukturat akademike, ndihmësakademike dhe administrative, njësitë kryesore, njësitë bazë

dhe njësitë e tjera, personeli akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët.

Neni 4 Qëllimi

Kjo Rregullore synon të mandatojë dhe të garantojë mbështetjen, sigurimin dhe arritjen e cilësisë, vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë, sigurimin e një evidence për të gjithë të interesuarit për nivelin e cilësisë së arritur nga KU "LOGOS".

KREU II POLITIKA DHE FUSHA TË SIGURIMIT TË CILËSISË

Neni 5 Politika dhe parime për sigurimin e cilësisë

1. Veprimtaria për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga politika për sigurimin e cilësisë e cila miratohet nga Senati Akademik i KU "LOGOS".
2. Hartimi dhe ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë është një proces gjithëpërfshirës, i hapur dhe transparent.
3. KU "LOGOS" e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.
4. Ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë është një proces që përfshin: rishikimin, përditësimin e parimeve, standardeve, treguesve, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit.
5. KU "LOGOS" zbaton parime dhe standarde të cilësisë të miratuara nga Senati Akademik.

Neni 6 Fusha dhe qasje të vlerësimeve në kuadër të sigurimit të cilësisë

1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë përqendrohet në fushat e caktuara në dokumentin e Politikës për Sigurimin e Cilësisë, në këtë Rregullore, në përputhje me dokumentet rregullatore të KU "LOGOS" dhe me Kodin e Cilësisë.
2. Fusha të vlerësimit të brendshëm janë: veprimtaria tërësore e institucionit, programet e studimit, mësimdhënia, kërkimi shkencor, arritjet e studentëve, shërbimet për studentët, performanca e personelit dhe menaxhimi i institucionit.

Neni 7

Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi

1. Në funksion të sigurimit të cilësisë në KU "LOGOS" kryhet kjo veprimtari monitoruese:

- a) monitorim sistematik i respektimit nga KU "LOGOS" të kornizës ligjore dhe rregullatore; të kritereve të kurrikulave; të kritereve të pranimit të studentëve; të kritereve të vlerësimit të studentëve; të kritereve të pranimit dhe të performancës në punë të personelit akademik; ndihmësakademik dhe administrativ, të kritereve të menaxhimit të institucionit, të kritereve të menaxhimit të burimeve materiale dhe financiare;
- b) monitorim sistematik i treguesve të cilësisë së personelit akademik;
- c) monitorim sistematik i treguesve të cilësisë së studentëve;
- d) monitorim sistematik i treguesve të cilësisë së kërkimit shkencor;
- e) monitorim sistematik i treguesve të cilësisë së shërbimeve për studentët;
- f) monitorimi sistematik i treguesve të infraskukturës.

2. Në funksion të sigurimit të cilësisë në KU "LOGOS" kryhet kjo veprimtari e vlerësimit të brendshëm:

- a) vlerësimi i brendshëm në nivelin e institucionit, të njësisë kryesore, të njësisë bazë;
- b) vlerësim i brendshëm për programet e studimit dhe mësimdhënien;
- c) vlerësim i veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- d) vlerësimi i performancës së drejtuesve të njësisë bazë, personelit akademik, ndihmësakademik, dhe administrativ;
- e) vlerësim i nevojave për trajnim të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ;
- f) vlerësim i cilësisë së arritjeve të studentëve;
- g) vlerësim i nevojave të studentëve për shërbime akademike, ligjore, psiko-sociale;
- h) vlerësimi i tregut të punës për zhvillimin strategjik të KU "LOGOS";
- i) auditim financiar.

3. Në funksion të sigurimit të cilësisë, në bazë të raporteve të monitorimit dhe të vlerësimit, në KU "LOGOS" kryhet përmirësimi i kërkuar.

4. Monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi bëhet në mënyrë periodike dhe për raste të veçanta. Monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi për raste të veçanta bëhet me vendim të Senatit Akademik kur gjykohet se është e rëndësishme për sigurimin e cilësisë.

KREU III

**ORGANET, AUTORITETET DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR SIGURIMIN
E CILËSISË**

Organet, autoritetet dhe strukturat në nivel institucioni

Neni 8

Senati Akademik

1. Senati Akademik i KU "LOGOS", si organi më i lartë drejtues akademik, përmbush këto funksione lidhur me sigurimin e cilësisë:
 - a) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në KU "LOGOS";
 - b) miraton politikën e institucionit për sigurimin e cilësisë;
 - c) miraton Planin Strategjik të Zhvillimit të KU "LOGOS", ku siguri dhe menaxhimi i cilësisë janë pjesë të rëndësishme të tij;
 - d) miraton Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor të KU "LOGOS" ku treguesit e cilësisë së kërkimit shkencor janë pjesë përbërëse të tij;
 - e) miraton Rregulloren për Sigurimin e cilësisë së KU "LOGOS" dhe aktet e tjera për cilësinë;
 - f) miraton Manualin e Cilësisë dhe Paketën e Instrumenteve të Cilësisë;
 - g) miraton instrumentet dhe procedurat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
 - h) miraton planin vjetor të vlerësimit;
 - i) ngre Komisionin e Sigurimit të Cilësisë (KSC);
 - j) miraton kriteret për për zgjedhjen e anëtarëve të KSC-së dhe të vlerësuesve për vlerësimin e brendshëm;
 - k) miraton anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSC) të propozuar nga Rektori;
 - l) miraton listën e ekspertëve dhe të vlerësuesve të brendshëm të KU "LOGOS" që mund të jenë në dispozicion për qëllime të vlerësimit të brendshëm dhe të akreditimit të institucionit dhe të programeve të studimit;
 - m) miraton përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të KU "LOGOS";
 - n) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së KU "LOGOS", të hartuar nga Rektorati dhe ia përcjell atë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR);
 - o) miraton raportin e vlerësimit të brendshëm për institucionin;
 - p) miraton format e komunikimit të rezultateve të monitorimit, vlerësimit, akreditimit për komunitetin e universitetit dhe publikun e gjerë.

2. Senati Akademik ka autoritet vendimmarrës dhe për këtë arsye mbikëqyr cilësinë edhe mbi një sërë çështjesh të tjera akademike, siç janë miratimi i kurrikulave, miratimi i rregulloreve të studimeve akademike dhe të kërkimit shkencor, të pranimit të studentëve, të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit; të rekrutimit të personelit; si dhe të cilësisë së shërbimeve për studentët.

Neni 9

Bordi i Administrimit

Bordi i Administrimit, si organi më i lartë kolegjal administrativ, përmbush këto funksione lidhur me vlerësimin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë:

- a) garanton mbështetjen e nevojshme financiare dhe logjistike për të realizuar veprimtaritë e monitorimit dhe të vlerësimit në kuadrin e sigurimit të cilësisë;
- b) miraton hapjen, riorganizimin e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë të KU "LOGOS";
- c) miraton buxhetin për veprimtaritë e vlerësimit të KU "LOGOS", të KSC-së dhe për NJSC-së të KU "LOGOS";
- d) ka përgjegjësinë për auditimin e brendshëm financiar;
- e) miraton raportin vjetor të auditimit të brendshëm;
- f) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektorati;
- g) është përgjegjës për caktimin e kriterëve dhe të procedurave për punësimin e personelit administrativ, mbështetur në aktet rregullatore të KU "LOGOS".

Neni 10

Komisioni i Sigurimit të Cilësisë i KU "LOGOS"

1. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë është organ kolegjal që vepron në nivel institucioni dhe ka përgjegjësinë për të garantuar se veprimtaria e KU "LOGOS" e përmbush misionin e tij dhe i plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet përpara Senatit Akademik për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të menaxhimit të cilësisë dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe e këshillon Senatin Akademik për çështjet e cilësisë.
2. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në këtë Rregullore si dhe në Rregulloren e punës së KSC-së. Ky komision mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj.
3. KSC-ja ka të paktën tre anëtarë, personel akademik me tituj akademikë dhe grada shkencore, një anëtar i Senatit Akademik dhe një student.

4. Anëtarët e KSC-së vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat 2- vjeçar me të drejtë rikandidimi. Së paku 1/3 e anëtarëve duhet të vijnë detyrën edhe për një vit, që të sigurohet vijimësia e punës. Anëtarët e personelit akademik duhet të kenë tituj akademikë dhe grada shkencore, një përvojë pune në arsimin e lartë, përvojë të konsiderueshme në fushën e sigurimit të cilësisë dhe të zotërojnë integritet të lartë dhe aftësi të mira komunikimi. Përfaqësuesi i studentëve duhet të ketë rezultate të larta akademike (8,5 e lart), aftësi të mira analizuese, vlerësuese dhe komunikimi. Kryetari i KSC-së duhet t'i përkasë kategorisë "Profesor". Kryetari dhe Sekretari i KSC-së caktohen nga Senati Akademik.

Neni 11

Përgjegjësitë e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë

1. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë ka këto përgjegjësi:
 - a) i propozon Senatit Akademik politikat, standardet, procedurat dhe mekanizmat për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kodin e Cilësisë, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe udhëzimet evropiane dhe ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë;
 - b) i propozon Senatit Akademik Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë si dhe ndryshime të saj;
 - c) rivlerëson politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë dhe i paraqet ndryshimet përkatëse Senatit Akademik;
 - d) përgjigjet për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të akreditimit të KU "LOGOS";
 - e) i propozon Senatit Akademik planet për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të standardeve shtetërore të cilësisë për institucionin dhe programet e studimit;
 - f) i propozon Senatit Akademik kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të KSC-së dhe të vlerësuesve për vlerësimin e brendshëm;
 - g) i propozon Senatit Akademik një listë të ekspertëve dhe të vlerësuesve të KU "LOGOS" që mund të jenë në dispozicion për qëllime të vlerësimit të brendshëm dhe të akreditimit të institucionit dhe të programeve të studimit;
 - h) i propozon Senatit Akademik përbërjen e GVB-së të cilësisë së KU "LOGOS";
 - i) i paraqet Senatit Akademik një raport vjetor mbi veprimtaritë dhe rezultatet në fushën e sigurimit të cilësisë së KU "LOGOS";
 - j) i propozon Senatit Akademik për miratim Manualin e Cilësisë së KU "LOGOS", përditësimin dhe përmirësimin e tij;
 - k) i propozon Senatit Akademik për miratim Paketën e instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimin e saj;

- l) i propozon Senatit Akademik Paketën e treguesve të cilësisë së kurrikulave; Paketën e standardeve dhe të treguesve të performancës së personelit; Paketën e treguesve të arritjeve të studentëve, Paketën e treguesve të cilësisë së kërkimit shkencor, Paketën e treguesve të shërbimeve për studentët; Paketën e treguesve të infrastrukturës së KU “LOGOS”.
 - q) i propozon Senatit Akademik format e publikimit të rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit për komunitetin e KU “LOGOS” dhe publikun e gjerë;
 - r) shqyrton ankesat në kuadrin e vlerësimit të brendshëm;
 - a) i paraqet Senatit Akademik raportin vjetor të KU “LOGOS” të hartuar nga NJSC-ja në kuadrin e veprimtarive për monitorimin dhe vlerësimin në instituion.
2. KSC-ja mund të formojë grupe të vogla pune për të dhënë ekspertizë, këshilla ose për të tërhequr mendime për çështje të sigurimit të cilësisë.

Neni 12

Përgjegjësi të kryetarit të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë

Kryetari i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë përmbush këto përgjegjësi:

- a) planifikon, organizon dhe koordinon punën e Komisionit;
- b) ngre grupe të vogla pune në përputhje me detyrat e Komisionit;
- c) realizon komunikimin zyrtar me Senatin Akademik, rektorin e KU “LOGOS”, administratorin e KU “LOGOS”, përgjegjësin e NJSC-së dhe me ASCAL-in;
- d) raporton në Senatin Akademik për veprimtarinë e KSC-së;
- e) kryen punë të tjera që lidhen me sigurimin e cilësisë.

Neni 13

Përgjegjësi të sekretarit të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë

Sekretari i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë përmbush këto përgjegjësi:

- a) mban dokumentacionin e Komisionit;
- b) mban procesverbalet e takimeve;
- c) përgatit shkresat e Komisionit;
- d) mban kontakte me Sekretarin e Senatit Akademik, Rektorin dhe NJSC-në e KU “LOGOS”;
- e) publikon vendimet dhe njoftimet e Komisionit.

Neni 14
Rektori i KU "LOGOS"

Rektori i KU "LOGOS" ka këto përgjegjësi lidhur me sigurimin e cilësisë:

- b) garanton se ekzistojnë kushtet e duhura në KU "LOGOS" për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe të akreditimit;
- c) siguron akses në të dhënat për vlerësimin që bëhet në përputhje me këtë Rregullore;
- d) garanton se rezultatet e vlerësimeve përkthehen në masa operative për përmirësimet e duhura;
- e) ngre, mbështet dhe mbikëqyr veprimtarinë e NJSC-së të KU "LOGOS";
- f) emëron në detyrë punojësit e NJSC-së të KU "LOGOS";
- g) i propozon KSC-së nisjen e monitorimeve dhe vlerësimeve;
- h) drejton procesin e vlerësimit të brendshëm;
- i) drejton procesin e monitorimit të treguesve të cilësisë;
- j) drejton monitorimin për zbatimin efektiv të politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni;
- k) drejton monitorimin për efektet e veprimtarive për përmirësimin e cilësisë në institucion;
- l) i paraqet Senatit Akademik raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektorati;
- m) drejton procesin mbështetës për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimit;
- n) bashkëpunon me të gjitha organizmat dhe autoritetet e KU "LOGOS";, me MASR, me ASCAL për përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë.

Neni 15
Administratori i KU "LOGOS"

Administratori i KU "LOGOS" ka këto përgjegjësi lidhur me vlerësimin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë:

- a) garanton se ekziston mbështetja financiare e nevojshme për të realizuar veprimtaritë e monitorimit dhe vlerësimit në kuadrin e sigurimit të cilësisë;
- b) siguron hapësirë për zyrë dhe logjistikë për KSC-në dhe NJSC-në e KU "LOGOS";
- c) përgjigjet për përmbushjen e treguesve të cilësisë së infrastrukturës dhe të shërbimeve logjistike për personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe të studentëve;
- d) propozon buxhetin për veprimtaritë e vlerësimit të KU "LOGOS"; të KSC-së dhe të NJSC-së të KU "LOGOS";

- e) ka përgjegjësinë për auditimin e brendshëm financiar;
- f) i paraqet Bordit të Administrimit raportin e detajuar vjetor të auditimit;
- g) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e personelit administrativ, mbështetur në aktet e KU “LOGOS”;
- h) bën vlerësimin e performancës së personelit administrativ.

Neni 16

Njësia e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni

1. Njësia e Sigurimit të Cilësisë në nivel insstitucioni është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi është në varësi të Rektorit të KU “LOGOS”.
2. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të drejtojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi. Kjo njësi luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së cilësisë që ndikon të arrijë dhe të ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të KU “LOGOS”.
3. NJSC-ja e KU “LOGOS” ka këto detyra:
 - a) zbaton politikën për sigurimin e cilësisë;
 - b) përgatit dhe përditëson Manualin e Cilësisë, Paketën e instrumenteve për sigurimin e cilësisë dhe materiale të tjera ndihmëse për realizimin e procedurave të monitorimit dhe të vlerësimit të cilësisë;
 - c) planifikon veprimtaritë monitoruese dhe organizon veprimtaritë periodike të monitorimit për zbatimin e legjislacionit, rregulloreve dhe udhëzimeve të treguesve të cilësisë;
 - d) planifikon vlerësimin e brendshëm institucional dhe të programeve të studimit;
 - e) bën planin e veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese për çdo vit akademik;
 - f) organizon veprimtari periodike të vlerësimit të cilësisë;
 - g) vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe shërbyese;
 - h) në fund të çdo semestri, para sesionit të provimeve, organizon vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies nga sstudentët;
 - i) në përfundim të çdo viti akademik, organizon vlerësimin për cilësinë e veprimtarisë së njësive bazë dhe të shërbimeve për studentët;
 - j) realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga KU “LOGOS”;

- k) përgatit dosjen e vlerësimit të brendshëm;
- l) organizon veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë;
- m) bashkëpunon me ASCAL-in për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e KU "LOGOS";
- n) përgatit paketën e akreditimit dhe ndjek procesin e akreditimit;
- o) organizon trajnime për sigurimin e cilësisë me GVB në nivel institucioni dhe të njësive kryesore, me personelin akademik, administrativ, studentët dhe drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë;
- p) ndan praktikatat më të mira të sigurimit të cilësisë me të gjithë komunitetin e institucionit;
- q) mbështet veprimtarinë e KSC-së të KU "LOGOS";
- r) i asiston GVB të KU "LOGOS" në përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm;
- s) bashkërendon punën me GVB të njësive kryesore dhe u ofron atyre shërbime këshillimi për vlerësimin e brendshëm dhe përmirësimin e cilësisë;
- t) parashikon burimet e nevojshme financiare për mbulimin e gjithë aktiviteteve të procesit të sigurimit të cilësisë;
- u) informon komunitetin e KU "LOGOS" dhe publikun për rezultatet e monitorimit, vlerësimit dhe të akreditimit nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit;
- v) krijon, pasuron dhe mirëmban sistemin e përpunimit dhe të ruajtjes së të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm;
- w) regjistron rezultatet e të gjitha monitorimeve, vlerësimeve dhe akreditimeve institucionale dhe të programeve;
- x) merr pjesë në programet e trajnimit që organizon ASCAL;
- y) bashkëpunon me NJSC-të e institucioneve të tjera të arsimit të lartë për të shkëmbyer përvojën.

Neni 17

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm i KU "LOGOS"

1. Në kuadrin e vlerësimit të brendshëm, ngrihet dhe funksionon Grupi i Vlerësimit të Brendshëm i KU "LOGOS". Ky është një organizëm ad hoc që krijohet sa herë ndërmerren veprimtari vlerësimi. GVB-ja e KU "LOGOS" ka si detyrë kryerjen e vlerësimeve të brendshme dhe hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për Universitetin. GVB-ja e KU "LOGOS" ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. GVB-ja e kryen vlerësimin e brendshëm të KU "LOGOS" sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë dhe i komunikon rezultatet e vlerësimit KSC-së, drejtuesve KU "LOGOS" .
2. GVB-ja e KU "LOGOS" ka në përbërje të tij nga një përfaqësues të personelit akademik nga të gjitha njësitë kryesore, një përfaqësues të personelit

ndihmësakademik dhe administrativ dhe një përfaqësues të studentëve. Anëtarët e GVB-së të KU “LOGOS” duhet të kenë përvojë në vlerësimin e brendshëm, aftësi të mira analitike dhe komunikimi. Përbërja e GVB në nivel institucioni i propozohet KSC-së nga Rektori, ndërsa përbërja e GVB-ve të njësive kryesore i propozohen KSC-së nga drejtuesit e njësive kryesore. KSC-ja ia paraqet GVB-të për miratim Senatit Akademik.

Neni 18

Këshilli i Studentëve

Studentët sipas legjislacionit në fuqi kanë të drejtë të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionin e arsimit të lartë. Këshilli i Studentëve shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve. Përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në KSC-në në nivel institucioni si dhe në GVB në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Studentët marrin pjesë në sigurimin e cilësisë nëpërmjet plotësimit të formularëve, pyetësorëve, nëpërmjet pjesëmarrjes në intervista, fokus grupe si dhe janë pjesë e Sondazhit Kombëtar të Studentëve, i cili zhvillohet çdo tre vjet nga ASCAL.

Organizmat dhe autoritetet dhe strukturat në nivel njësie kryesore

Neni 19

Drejtuesi i njësisë kryesore

Drejtuesi i njësisë kryesore ka këto përgjegjësi lidhur me sigurimin e cilësisë:

- a) garanton se ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit në kuadrin e sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore;
- b) garanton se rezultatet e vlerësimeve përkthehen në masa operative për përmirësimet e duhura;
- c) drejton vlerësimin e brendshëm, monitorimin dhe procesin e akreditimit;
- d) zbaton vendimet, udhëzimet dhe detyrat e ngarkuara nga Senati Akademik, Rektori dhe KSC-ja e KU “LOGOS” për vlerësimin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë;
- e) propozon përfaqësues të njësisë kryesore për GVB-në e KU “LOGOS”;
- f) propozon GVB-në e njësisë kryesore;
- g) shqyrton gjithë materialet dhe rekomandimet e vlerësimit për të garantuar se procedurat e vlerësimit janë kryer në rregull dhe për të marrë vendimet përkatëse për njësitë bazë ose personat;

- h) kryen vlerësimin e performancës së drejtuesve të njësive bazë.

Neni 20

Drejtuesi i njësisë bazë

Drejtuesi i njësisë bazë ka këto përgjegjësi lidhur me sigurimin e cilësisë:

- a) garanton se ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit në kuadrin e sigurimit të cilësisë në njësinë bazë;
- b) garanton se rezultatet e vlerësimeve përkthehen në masa operative për përmirësimet e duhura;
- c) propozon përfaqësues të njësisë bazë për GVB-në e njësisë kryesore;
- d) mbështet veprimtarinë e GVB;
- e) zbaton udhëzimet dhe detyrat e ngarkuara nga drejtuesi i njësisë kryesore, NJSC-ja e KU "LOGOS" dhe NJSC-ja e njësisë kryesore;
- f) shqyrton të gjitha materialet e vlerësimit për njësinë që mbulon dhe në mënyrë të veçantë formularët e vlerësimit të studentëve dhe raportet e vetëvlerësimit të pedagogëve;
- g) e përdor informacionin e vlerësimit për qëllime të përmirësimit të veprimtarisë së njësisë që drejton, të përmirësimit të programeve të studimit dhe të promovimit të personelit akademik;
- h) kryen vlerësimin e performancës së personelit akademik që punon në njësinë bazë që drejton.
- i)

Neni 21

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të njësisë kryesore

1. Në kuadrin e vlerësimit të brendshëm, ngrihet dhe funksionon Grupi i Vlerësimit të Brendshëm i njësisë kryesore. Ky është një organizëm ad hoc që aktivizohet sa herë ndërmerren veprimtari vlerësimi. GVB-ja e njësisë kryesore ka si detyrë kryerjen e vlerësimeve të brendshme dhe hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për njësinë kryesore. GVB-ja e njësisë kryesore ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. GVB-ja kryen vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë dhe i komunikon rezultatet e vlerësimit drejtuesit të njësisë kryesore, drejtuesit të njësisë bazë, Komitetit Shkencor të Programit, Asamblesë së Personelit Akademik, personelit ndihmësadministrativ dhe administrativ dhe përfaqësuesve të studentëve.

2. GVB-ja e njësisë kryesore ka në përbërje të tij nga një përfaqësues të personelit akademik nga të gjitha njësitet bazë, një përfaqësues të personelit ndihmësakademik dhe administrativ dhe një përfaqësues të studentëve. Anëtarët e GVB-së të njësisë kryesore duhet të kenë përvojë në vlerësimin e brendshëm, aftësi të mira analitike dhe komunikimi. GVB-ja e njësisë kryesore ngrihet nga drejtuesi i njësisë kryesore në bazë të propozimeve nga njësitet bazë dhe studentët.

Neni 22

Përgjegjësitë e atyre që marrin pjesë në vlerësim dhe vlerësohen

1. Çdo anëtar i komunitetit të KU "LOGOS" duhet të përmbushë përgjegjësitë që ka për vlerësimin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë.
2. Çdo anëtar i njësisë kryesore dhe bazë duhet të përcaktojë për çdo vit akademik qëllimet dhe objektivat e veprimtarisë së vet.
3. Çdo person i vlerësuar duhet të zotërojë përmbledhjen e vlerësimit të dhënë për të.
4. Çdo person i vlerësuar duhet të ketë mundësinë të diskutojë raportin e shkruar për të para se ai t'i kalojë drejtuesit të nivelit më të lartë. 10 ditë pas komunikimit të vlerësimit ka të drejtë të bëjë ankesë në KSC, bazuar në rregullat e përcaktuara në Statutin e KU "LOGOS", Rregulloren e Përgjithshme të KU "LOGOS" dhe Kodin e Procedurës Administrative.

KREU IV

PROCEDURA TË SIGURIMIT TË CILËSISË

Neni 23

Inicimi i vlerësimit

1. Vlerësimi i brendshëm, monitorimi dhe procesi i akreditimit në nivel universiteti iniciohet nga Rektori i KU "LOGOS".
2. Vlerësimi i brendshëm, monitorimi dhe procesi i akreditimit në nivelin e njësisë kryesore iniciohet nga Drejtuesi i njësisë kryesore.
3. Auditimi financiar iniciohet nga Administratori i KU "LOGOS" për institucionin.
4. Veprimtari vlerësuese mund të iniciohen edhe në rastet kur kërkesa vjen nga MASR ose ASCAL.
5. Inicimi i vlerësimit të brendshëm bëhet në periudhat kohore të përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 24

Koha e vlerësimit dhe përmirësimit

1. Vlerësimi i brendshëm në kuadrin e akreditimit institucional i përshtatet dinamikës së vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit institucional, që si rregull bëhet çdo 6 vjet.
2. Vlerësimi i brendshëm në kuadrin e akreditimit të programeve i përshtatet dinamikës së vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit të programeve, që si rregull bëhet çdo 6 vjet.
3. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë kryhet çdo 4 vjet në përputhje me afatin kohor të vlerësimit të jashtëm që kryhet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
4. Përmirësimi i programeve të studimit mund të kryhet deri në masën 20% brenda periudhës kohore të akreditimit të radhës sipas legjislacionit në fuqi.
5. Vlerësimi me qëllim përmirësimin e cilësisë kryhet sipas nevojës së identifikuar.
6. Vlerësimi i programeve mësimore të lëndëve bëhet çdo vit me qëllim përditësimin dhe miratimin e tyre nga drejtuesi i njësisë bazë.
7. Vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies kryhet çdo vit.
8. Vlerësimi i veprimtarisë së njësisë bazë dhe të shërbimeve për studentët bëhet çdo vit.
9. Vlerësimi i personelit akademik bëhet çdo vit nga drejtuesi i njësisë bazë.
10. Vlerësimi i drejtuesve të njësive bazë kryhet çdo vit nga drejtuesi i njësisë kryesore.
11. Vlerësimi i performancës së pedagogut të ri në profesion bëhet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe një grup i kolegëve me tituj akademikë çdo vit për tre vitet e para.
12. Vlerësimi i pedagogëve për fitimin e titujve akademikë bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
13. Vlerësimi i personelit ndihmësadministrativ dhe administrativ kryhet çdo vit.
14. Vlerësimi i projekteve të zhvillimit dhe kërkimit kryhet çdo vit.
15. Auditimi financiar kryhet çdo vit.
16. Vlerësimi i nevojave të studentëve dhe të personelit kryhet çdo vit.
17. Vlerësimi i shërbimeve për studentët kryhet çdo vit.

Neni 25

Burime dhe instrumente të vlerësimit të brendshëm

1. Vlerësimi i brendshëm bazohet në:
 - a) dokumentet ligjore e rregullatorë, strategjikë, dhe të tjera dokumente të KU "LOGOS", të njësive kryesore, njësive bazë dhe njësive të tjera;
 - b) të dhënat nga sistemet e informacionit të KU "LOGOS", njësive kryesore, njësive bazë, njësive të tjera ose burimeve të tjera publike;

- c) treguesit e përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të KU “LOGOS”, në Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor të KU “LOGOS” dhe në Raportin vjetor të KU “LOGOS”;
- d) vlerësimet e drejtuesve;
- e) vlerësimet e ekspertëve;
- f) vlerësimet e kolegëve;
- g) vlerësimet e studentëve;
- h) vlerësimet e të diplomuarve;
- i) vlerësimet e bashkëpunëtorëve;
- j) vlerësimet e punëdhënësve;
- k) të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, plotësimit të formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit;
- g) analizat bibliometrike.

2. Procesi i sigurimit të cilësisë mbështetet nga Manuali i Cilësisë, Paketa e Instrumenteve dhe dokumentet e tjera udhëzuese të miratuara nga Senati Akademik.

Neni 26

Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit

- 1. KU “LOGOS” dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit.
- 2. Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe akreditimit bëhet në përputhje me format e miratuara nga Senati Akademik i KU “LOGOS”.
- 3. KU “LOGOS” garanton se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet me një gjuhë të kuptueshme për të gjithë. Ky proces mbikëqyret nga NJSC-ja në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Informacioni përditësohet rregullisht.
- 4. Komunikimi dhe publikimi kryehen në këto mënyra:
 - a) Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të KU “LOGOS”.
 - b) Raportet e vlerësimit të brendshëm bëhen publike.
 - c) Raportet e vlerësimit të jashtëm bëhen publike.
 - d) Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike.
 - e) Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmbledhur.

- f) Raporetet e vlerësimeve individuale të drejtuesve të njësive bazë, të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administativ u komunikohen individualisht individëve.
- g) Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve.
- h) Raportet e vlerësimit shkruhen sipas udhëzimeve të paraqitura në Manualin e Cilësisë së KU “LOGOS”.

Neni 27

Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit

- 1. Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të parashikuara në këtë Rregullore përdoren për:
 - a. përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm,
 - b. për akreditimin;
 - c. për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit;
 - d. për planifikimin vjetor dhe strategjik të KU “LOGOS” ;
 - e. për përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 28

- 1. Kjo Rregullore shqyrtohet në mënyrë periodike nga ana e KSC-së së KU “LOGOS” që i propozon Senatit Akademik përditësimin ose/dhe ndryshimet përkatëse.
- 2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senatin Akademik të KU “LOGOS”.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Nikoleta Mita

RREGULLORE PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Skeda protokollare e dokumentit

	Kolegji Universitar "LOGOS"
Emërtimi i dokumentit	Rregullore për Sigurimin e Cilësisë
Organi miratues	Senati Akademik i Kolegjit Universitar "LOGOS"
Numri i vendimit të miratimit	15
Data e miratimit	25.02.2019
Numri i faqeve të Rregullores	18
Numri i dokumentit që miraton ndryshimet	
Data e ndryshimit	
Nenet dhe pikat e ndryshuara	
Numri i faqeve pas ndryshimit	